



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



14-111/01-161264/18

Dt.06.07.2018

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.	Niveli	Pozita	Vend ilirë/Zëvendësim	Numri i pozitive
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për sociologji	Zëvendësim	1
2	ShML	Mësimdhënës/e për sociologji	Zëvendësim	1
3	ShFMU	Mësimdhënës/e për histori	Zëvendësim	1
4	ShML	Mësimdhënës/e për histori	Zëvendësim	1
5	ShFMU	Mësimdhënës/e për gjeografi	Vend I lirë	2
6	ShML	Mësimdhënës/e për gjeografi	Vend I lirë	2
7	ShFMU	Mësimdhënës/e për gjeografi	Zëvendësim	3
8	ShML	Mësimdhënës/e për biologji	Zëvendësim	1
9	ShFMU	Mësimdhënës/e për kimi	Vend I lirë	1
10	ShFMU	Mësimdhënës/e për kimi	Vend I lirë	2
11	ShFMU	Mësimdhënës/e për kimi	Zëvendësim	1
12	ShFMU	Mësimdhënës/e për fizikë	Vend I lirë	1
13	ShML	Mësimdhënës/e për fizikë	Vend I lirë	1
14	ShFMU	Mësimdhënës/e për fizikë	Zëvendësim	1
15	ShFMU	Mësimdhënës/e për edukatë qytetare	Zëvendësim	1
16	ShML	Mësimdhënës/e për edukatë qytetare	Zëvendësim	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;**

- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore **(nëse ka)**.

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 06/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për sociologji në shkollë të mesme të ultë dhe të lartë:

- Fakulteti Filozofik –dega e sociologjisë;
- Fakulteti Filozofik - dega filozofi – sociologji;
 - Master;
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelori (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për histori në shkollë të mesme të ulët:

- Fakulteti i Edukimit – programi: histori – edukatë qytetare/gjeografi – edukatë qytetare;
- Fakulteti Filozofik –dega e historisë;

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për histori në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Edukimit – Programi Master i Mësimdhënies së historisë ose Histori – Edukatë qytetare;
- Fakulteti Filozofik –dega e historisë;
 - Master;
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelori (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për gjeografi në shkollë të mesme të ulët:

- Fakulteti i Edukimit – programi: gjeografi – edukatë qytetare;
- FSHMN –dega e gjeografisë;

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për gjeografi në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Edukimit – Programi Master i Mësimdhënies në Gjeografi ose Gjeografi - Edukatë Qytetare;
- FSHMN –dega e gjeografisë arsimore;
 - Niveli Master;
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelori (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime në biologji në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Edukimit – Programi Master i Mësimeve në Biologji - Kimi ose Biologji
- FSHMN –dega e biologjisë arsimore;
 - Niveli Master;
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime në kimi në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Edukimit – Programi Master i Mësimeve në Biologji - Kimi ose Kimi
- FSHMN –dega e kimit arsimore;
 - Niveli Master;
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime në fizikë në shkollë të mesme të ulët:

- Fakulteti i Edukimit – programi: fizikë– kimi/kimi - fizikë;
- FSHMN – dega e fizikës arsimore;

Kriteret e kualifikimit për mësime në fizikë në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Edukimit – Programi Master i Mësimeve në Fizikë - Kimi ose Fizikë
- FSHMN –dega e fizikës arsimore;
 - Niveli Master;
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime në edukatë qytetare në shkollë të mesme të ulët:

- Fakulteti i Edukimit – Programi: histori – edukatë qytetare/gjeografi – edukatë qytetare;
- Fakulteti Filozofik –Dega e historisë;
- FSHMN – Dega e gjeografisë
- Fakulteti Filozofik – Dega e sociologjisë
- Fakulteti i Edukimit – Programi Pedagogji

Kriteret e kualifikimit për mësime në edukatë Qytetare në shkollë të mesme të lartë:

- Fakulteti i Edukimit – Programi Master i Mësimeve në Histori – Edukatë Qytetare ose Gjeografi – Edukatë Qytetare
- FSHMN –dega e historisë;
 - Niveli Master;
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelor (katërvjeçar)

SQARIM: Në institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), kandidatët duhet të kenë së paku 300 ETCS, përkatësisht 5 vite studime.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur për institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim të studimeve 4 vjeçar.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohet intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kritere:

Njohuritë e Përgjithshme 25 pikë,

Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit 35 pikë dhe

Njohuritë profesionale 40 pikë (Ku përfshihen përvoja e punës dhe nota mesatare gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuar diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në ëeb faqen e Komunes së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/>(konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2018, por në varësi të lirimimit real i vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor shtator, 2018 – gusht, 2019 (komplet viti shkollor). Në rast të ndonjë nevoje eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: **06/07/2018 deri më datën 20/07/2018.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Nëse aplikohet për dy pozita (vend i lirë dhe zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta.